

**Burimet:** J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; KMDLNJ, *Buletini*, num. 7, prill-qershor 1998, 143, FDH-23816.

## Mustafë (Kamer) Cacaj

(1927, shqiptar nga Deçani/Deçane, bujk)

Mustafa i moshëthyer jetonte vetëm në **Deçan/Deçane**, në shtëpinë e cila ndodhej në afërsi të rrugës kryesore Deçan/Deçane - Gjakovë/Đakovica. Ishte shurdhmemec. Në datën 27.05.1998, ai, së bashku me disa të afërm, ka kaluar te komshiu i parë, Hysen Demukaj. Ditën e nesërme, më **28.05.1998**, Mustafa ka dalë nga shtëpia dhe nuk u kthye kurrë më. Nuk i ka thënë askujt se ku po shkonte. Nga ajo ditë i është humbur çdo gjurmë. Zhdukja e Mustafës është evidentuar nga KNKK-ja, në lëndën që është sistemuar me numrin rendor BLG-803248-01.

**Burimet:** deklarata A.S, FDH-17036; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

## Isa (Lush) Kuçi

(10.05.1955, shqiptar nga Deçani/Deçane, berber, pjesëtar i UÇK-së)

Isa ka punuar në fabrikën *Metaliku* deri në vitin 1989, kur pushteti serb e ka pushuar nga puna. Nga ajo kohë, ai ka punuar si berber në Deçan/Deçane. Menjëherë pas fillimit të luftës në Kosovë, Isa u paraqit në UÇK. Në datën **28.05.1998**, Isa ka rënë gjatë përleshjeve të armatosura me forcat serbe në **Deçan/Deçane**. Trupi i tij u identifikua më 15.07.1999 dhe, më pas, ai u varros në Deçan/Deçane.

**Burimet:** J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596.

## Ilija (Miloš) Antić

(18.07.1934, serb nga Lloqani/Loçane, komuna e Deçanit/Deçani, pesë fëmijë)

Ilija jetonte në Lloqan/Loçane me djalin Momčilo dhe familjen e tij. Momčilo ka qenë oficer policie në Deçan/Deçane. Ai me familje kanë kaluar në Pejë/Peć për Kërshëndellat Ortodokse, më 19.04.1998. Ilija ka mbetur vetëm në shtëpi. Edhe serbë

të tjerë, madje edhe të rinj në mesin e tyre, po ashtu, mbetën në fshat. Momčilo e vizitonte shpesh të atin dhe i çonte ushqime. Bashkëshortja e vëllait të Iliut, Milosava Antić, ka qenë e fundit që e shihte Iliun të gjallë, më **28.05.1998**. Atë ditë, në mbrëmje, Ilija e kishte vizituar atë. Po në atë mbrëmje, në fshat [**Lloqan/Loçane**] dëgjoheshin të shtëna. Në mëngjesin e ditës tjetër, ajo shkoi te Ilija dhe gjeti shtëpinë e mbyllur me dry. Por, drita në brendi të shtëpisë nuk ishte e fikur dhe televizori ende punonte. Fati i Ilisë u ndriçua në muajin shtator të vitit 1998, kur autoritetet serbe i zbuluan në kanalën e **Liqenit të Radoniqit/Radonjičko jezero** afro 30 trupa të serbëve, shqiptarëve dhe romëve të zhdukur, në mesin e të cilëve ishte edhe Ilija. Në xhepat e tij ishte gjetur edhe çelësi i shtëpisë. Patologët kanë konstatuar se Ilija i kishte të thyer kafkën, nofullën, brinjët, qafen, dorën e majtë dhe se ishte privuar nga jeta me të shtëna të shumta me armë zjarri. Ilija u varros në varrezat e Lloqanit/Loçane më 19.09.1998.

**Burimet:** deklarata N.V, FDH-5566; deklarata B.M, FDH-31769; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; SMIP, *Teroristički...*, III, 904; KKMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; ICTY, IT-04-84 (R.Haradinaj dhe të tjerë), aktgjykimi, 03.04.2008, [http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaIReforma&int\\_cid=124&cat=Transkripti/Predmet-Haradinaj-i-drugi-\(-IT-04-84-\).](http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaIReforma&int_cid=124&cat=Transkripti/Predmet-Haradinaj-i-drugi-(-IT-04-84-).)

## Luljeta (Adem) Selmonaj

(15.12.1972, shqiptare nga Baballoqi/Babaloć, komuna e Deçanit/Deçani, teknike bujqësore)

Luljeta, 16 vjeçe, me familje jetonin në fshatin **Baballoq/Babaloć**. Vëllezërit i kishte në UÇK. Në datën 25.04.1998, forcat serbe filluan gjuajtjet me minahedhëset mbi fshatin. I ati e largoi familjen nga fshati, por Luljeta nuk deshi të largohej nga shtëpia. Ajo mbeti me të atin. Përkundër vazhdimet të granatimeve, pjesëtarë të larguar të familjes Selmonaj pas një muaji u kthyen në shtëpi. Më **29.05.1998**, një predhë e ka goditur Luljetën, përderisa ajo gjendej në katin e lartë të shtëpisë. E kishte qëlluar në stomak, duke e lënë të vdekur